

Abstrakt

Qëllimi i kësaj teme të masterit është ndërtimi i një teorie të përgjithshme të kontratave administrative. Në këtë punim jam përpjekur të trajtoj kontratën administrative si një institut juridik të së drejtës në Kosovë, ku zhvillimi i administratës publike pati një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kontratave, e të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm për të siguruar transparencën dhe efikasitetin duke ndikuar në rregullimin e marrdhënieve dhe në zbatimin e politikave dhe shërbimeve publike e cila është një mënyrë e mirë për të garantuar që të gjitha palët të kenë një kuptim të qartë për angazhimin dhe përgjegjësinë e tyre.

Idea e përhapur se kur bëhet fjalë për kontratat administrative, rregullat e të drejtës publike zbatohen deri në fazën e lidhjes së kontratës dhe pasë lidhjes, në fazën e zbatimit dhe të përfundimit të kontratës zbatohen thjeshtësisht dhe ekskluzivisht rregullat e të drejtës private, të cilat dallojnë pakësa nga drejta publike të cilat kanë të bëjnë me lidhjen e kontratave dhe zhvillimin e tyre në të drejtën administrative në kohën modern.

Pra në këtë punim do të trajtohet periudha kohore e zhvillimit të administratës dhe rëndësija e saj që ka ajo në të drejtën tonë, por duke trajtuar edhe funksionet që ajo ka sistemet e saja dhe zhvillimin kohor që ajo e ka pasur në Kosovë e cila ka kaluarë në periudha të ndryshme për të arritur zhvillimin e administratës publike dhe zhvillimi i kontratave të cilatë një farë mënyre rregullojnë raportet në mes organeve shtetërore dhe atyre publike